

## PRILL 1913, KUR SHKODRA E RRETHUAR VDISTE NGA URIA

Në fillim të prillit të vitit 1913 ushtrisë që mbronte Shkodrën, nën komandën e gjeneralit Esad pashë Toptani, po i mbaroheshin ushqimet, ndërsa nga radhët e popullsisë civile kishin filluar vdekjet nga uria. Më shumë se 30 vetë vdisnin çdo ditë. Në situatë të vështirë ishin edhe priftërinjtë katolikë dhe motrat stigmatine që rrezikoheshin nga vdekja e tmerrshme nga uria. Ata i shpëtoi komandanti i mbrojtjes së Shkodrës, Esad pashë Toptani, i cili nxori ushqimin për çdo ditë nga racioni i ushtarëve, deri sa përfundoi lufta.<sup>18</sup>

Sipas Hortense von Zambaur, rreth datës 20 prill qyteti i kishte magazinat bosh. Tmerri i urisë nga dita në ditë bëhej më kërcënues, të varfrit jetonin me gjak bagëtish të therura e me bar.<sup>19</sup>

Qeveria austriake bëri përpjekje diplomatike për të futur drithë në Shkodër. Ministri i Jashtëm, Bertold (Berchtold), udhëzonte kundëradmiralin Njegovan të propozonte Këshillit të Admiralëve të flotës ndërkombëtare të bënin një hetim në ishte i rrethuar nga të katër anët qyteti i Shkodrës dhe nëse kishte mundësi të futeshin nga jashtë sasira ushqimesh. Të njëjtën detyrë ia ngarkoi edhe ambasadorit në Cetinë.

*“Kundëradmiralin Njegovan po e porosit telegrafisht t’i proponojë Këshillit të Admiralëve, që të bëjë hetim në është e rrethuar Shkodra sot për sot me të vërtet më të katër anët dhe në është e mundur të futen në qytet lëndë ushqimore së jashtmi. Gjithashtu e ngarkoj ambasadorin t’ënë në Cetinjë që t’interesohej për çështjen e sipërme...”*

<sup>18</sup> Domenico Facin O.F.M., *I Frati Minor e Le Suore Stigmatine durante L’Assedio di Scutari*, Firenze, 1913.

<sup>19</sup> Hortense von Zambaur, *Rrethimi i Shkodrës (10 tetor 1912 – 22 prill 1913)*, Ditar, “Camaj – Pipa”, Shkodër, 2006, f. 116.

Bertold mendonte se qeveria serbe duhej t'i jepte urdhër gjeneralit Bojoviq, që po t'i lutej flota ndërkombëtare për të futur në Shkodër lëndë ushqimore, ai të mos i nxirrte pengesa. Ai porosiste ambasadorin austriak në Beograd, zotin von Ugron,

*"për t'i thënë zotit Pashiq që t'i japë një urdhër të tillë kryekomandantit serb".<sup>1</sup>*

*"Mbasi serbët nuk po marrin më pjesë në rrethimin e Shkodrës, jam i mendjes, se qeveria serbe duhet t'i japë urdhër gjeneralit Bojoviq, që po t'i lutet flota ndërkombëtare për të futur ajo në Shkodër lëndë ushqimore, të mos i nxjerrë ay pengime. Prandaj po e porosit zotin von Ugron për t'i thënë zotit Pashiq që t'i japë një urdhër të tillë kryekomandantit serb. Dhe i lutem Shkëlqesisë suaj t'i luteni qeverisë s'atyshme për t'i dhënë një porosi të tillë përfaqësonjësit të vet në Belgrad... Naratov i ka thënë ambasadorit, se po t'i dërgohet Shkodrës lëndë ushqimore së jashtmi, atëherë ay qënka i mendjes se Shkodra s'është më në rrezik, sepse tashti që u hoqën serbët, vetëm për vetëm malazestë nuk e shkelin dot qytetin me forcë".*

Në lidhje me planin austriak për futjen e ushqimeve në Shkodër, përfaqësuesi i Vjenës në Londër, Mansdorff, më 21 prill 1913 e bisedoi me kryeministrin anglez.

Ai i raportonte shefit të tij në Vjenë:

*"... Çështjen e dërgimit të lëndëve ushqimore për në Shkodër Kryeministri e quan pothuajse si një operetë lufte, e sidomos që nuk puqet me detyrat e neutralitetit. Në këtë punë nuk mund të fshtetemi në përkrahjen e qeverisë inglize. Gjithashtu kryeministri është fare kundër që të shkelen vende në bregdetin malazez prej detarësh ndërkombëtarë... Ai nuk dëshiron të vërë në rrezik detarët inglizë, që të bombardohen prej malazezëve".<sup>2</sup>*

<sup>1</sup> AQSH, fondi 591, viti 1913, dosja 2/1, nr. 6685. Tel. për Berlin, nr. 312 (1), Romë, nr. 397 (2), Petrograd, nr. 296 (3), Paris, nr. 234 (4), Londër, nr. 329 (5), Cetinjë, nr. 103 (6) dhe Beograd, nr. 122 (7), më 20 prill 1913.

<sup>2</sup> AQSH, fondi 591, viti 1913, dosja 2/1, nr. 6698. Tel. nga Londra, nr. 337, 21 prill 1913.

Në telegrafin e asaj date, Bertold e udhëzonte përsëri ambasadorin në Londër që t'i thoshte qeverisë së Londrës se

"në mos dashtë qeveria angleze të merren masa më të forta kundër Malit të Zi, atëherë dhe Franca do të bëjë si Inglia, sado që ajo e ka pas pëlqyer që të merren masa të forta. Mirëpo kjo gjë... do të na shtrëngojë q' Austro-Hungaria t'i përvishet punës vetëm për vetëm".<sup>3</sup>

Vetëm Italia ishte dakord me planin e Vjenës.

Nr. 6685. Tel. për Berlin Nr. 372(1), Romë Nr. 397(2),  
Betrograd Nr. 296(3), Paris Nr. 238(4), Londër Nr. 329(5),  
Cetini Nr. 103(6) dhe Belgrad Nr. 122(7) më 20. prill 1913.<sup>a</sup>

1. - 7. Kontëadmiralin Njagovan jo e porosit tel. e  
grafisht t'i propozojë Këshillit t'Admiralvet, <sup>q' të bëjë</sup> për ~~kon-~~  
<sup>helium</sup> ~~konstatuar~~, në isht e rrethuar Skadra sot për sot me të  
virtet në të katër anët dhe në isht e mundur të  
<sup>huten në 24h</sup> ~~delgohet~~ gjatë lëndë ushqimi në jashtëm.

1. - 5 e 7. Gjith ashtu jo e ngarkoj ambasadorin  
t'inë në Cetini q' t'interesohet për çështjen e sipërme.

<sup>3</sup> AQSH, fondi 591, viti 1913, dosja 2/1, nr. 6692. Tel. për Londër, nr. 335, 21 prill 1913.

6. Në shk. e Jugut duhet të hapni një për këtë punë.  
1. - 5. Fjalit e sipërme, lutem, t'i a thoni Qeverris i  
atëherë

1. - 2., 4. e 5. Në t'i luti që t'i japë instruksione  
analoge kumandantit të flotës në vet.

3. Në t'i shtoni, se go në lutem Qeverris të Fungës  
të Mitha që kanë marrë pjesë në demonstratën de-  
tare për t'u dhënë instruksione analoge kuman-  
dantit të vet.

1. - 6. Masi është mrek për marrjen në pjesë në  
rëthimin e Shkodrës, jam i mendës, se Qeverrisa s'është  
duhet t'i japë urdhrë gjeneralit Bojoriq, që po t'i  
lulet flota ndërkombëtare për të fratur ajo në Shkodë  
lindi ushqimare, të mos i ushqejnë që pengojnë Fran-  
dij go e porosit zotin von Ugron për t'i thënë zotit  
Pashiq që t'i japë një urdhrë të tillë kryeskomandantit  
harit në të =

1. - 5. Në lutem shk. e Jugut t'i thoni Qeverris i

qitë merrtet kurndin Malit të Zi' bin nëshkrypi të  
kege në Paris' dhe në Malë; Zi' dulet të vërtet me  
shpatulla për murr vërtim e vërtim kur t'a shohim  
se merr të japim asnjë fjalë të gjilthra masat e tyre.  
Z. Kërator: ka shënim ambasadorit, se po t'i dërgohet  
dhe Shkodrës lëndë ushqimi si jashtëm, atëherë një  
gjëka: munda se Shkodra s'është në një regjion, se  
nëse lëshon q' në lagje rëvohet, merrgjat vërtim për  
vërtim merrgjat merr e shohim dot qytetin në forcë.

Nr. 6686. Tel. nga Parisi, 20. prill 1913 Nr. 81. a)

Fola me gjuhë Pichon në themel të telegrafit të  
Shk. s' Uj' Nr. 235<sup>9</sup> me shk. m. Ky merr referencë  
telegrafi, nga të cilët njëri q' prej zotit Durmanis, ka  
shkruan ky se Mbret Nikolla p' tëz dori nga  
vetëtimi: Shkodrës. Në këto rrethana, t'ha q' do të  
merr jetë në merrgjat t'i vërtet Malit të Zi' lëshon në  
fjalë. Duket: shënim se fjalëve q' jep Mbret Nikolla merr